



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika-Odeljene za
Politike Pravosudnog Sistema, Slobodne Profesije I Statistiku- Department of Justice Sytem
Policies, Freelance Professions and Statistics

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.7/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr. 184/20, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija Kërveshi, Përmbaruesi Privat e në mungesë të palës ankuese me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga nga Prishtina, me datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika, DPSDPLS. 7/2025 i datës 15.05.2025, si dhe ankesa e palës ankuese me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga nga Prishtina, e datës 07.05.2025 si të pabazuara.

II. Përmbaruesi Privat organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.184/20.

A r s y e t i m

Pala ankuese me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga nga Prishtina, me datën 07.05.2025 ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat, pasi sipas ankesës, përmbaruesi privat me veprimet e tij ka bërë shkelje sipas nenit 24 (paragrafi 5), nenit 61 (paragrafi 1.1), nenit 67 (paragrafi 1.2) dhe nenit 367 (paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.4, 1.9 dhe 1.10) duke bllokuar të gjitha llogaritë bankare të mbështetur në Aktvendimin PPP.nr. 872/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe duke tërhequr nga llogaria bankare e mjete në vlerë prej 506.64 euro, pa aprovimin e Pala ankuese ka deklaruar se përmbaruesin privat ka njoftuar se kundër këtij aktvendimi të gjykatës, brenda afatit ligjor propozuesi ka ushtruar ankesë. Propozuesi pretendon se përkundër kësaj përmbaruesi privat nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të liruar llogaritë bankare të propozuesit, por ka faturuar për një borxh i cili është ende pa epilog e me këtë rast pretendohet se është dëmtuar shumë duke penguar funksionet operationale të

Në seancën e mbajtur, pala ankuese nuk ka marrë pjesë.

Përmbaruesi privat ka deklaruar në përgjigjen e tij se propozimi i lejuar me urdhërin lëndor P.nr.184/20, është dorëzuar tek debitori, i cili në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar prapësim dhe me vendimin e gjykatës, pjesërisht urdhëri ka mbetur në fuqi, mbi të cilin vendim të gjykatës edhe është vazhduar përmbarimi, pasi janë plotësuar kushtet ligjore për bllokim të llogarive për shumën që është mbetur në fuqi sipas vendimit të gjykatës lidhur me prapësimin, në emër të borgjit shuma prej 156 euro, për përpilim e propozimit nga avokati shuam prej 117 euro dhe shpenzimet tjera përmbarimore në shumën prej 233.64 euro.

Sipas përmbaruesit pas tërheqjes së këtyre mjeteve është përfunduar rasti dhe janë liruar llogaritë e debitorit me datën 06.05.2025 ku është dërguar edhe pasqyra e shpenzimeve tek debitori.

Në seancë përmbaruesi ka mbetur pranë përgjigjes në ankesë duke kërkuar që ankesa e ushtruar ndaj tij të refuzohet si e pabazuar, pasi nuk ka prova dhe fakte që mbështesin preendimet e palës ankuese.

Komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë me të cilën do provohej që përmbaruesi privat ka bërë tejkalim të autorizimeve apo ndonjë shkelje sipas pretendimeve në ankesë dhe nuk ka mundur të vërtetohet me provat e ofruara ndonjë shkelje ligjore.

Komisioni ka analizuar provat e ofruara, dhe ka pasur parasysh edhe deklarin e palës ankuese, për dhe veprimet e përmbaruesit, pasi shuma për të cilën është vazhduar përmbarimi është shuma që me vendimin e gjykatës lidhur me prapësimin e palës debitore, ka mbetur në fuqi dhe pasi dokument përmbarimor ka qenë vendimi i gjykatës, në momentin kur është refuzuar prapësimi pjesërisht për atë pjesë, janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdim të procedurës, sepse ankesa e parashtruar ndaj këtyre vendimeve tek këto raste, nuk e shtyen ekzekutimin. Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPSDPLS.nr.7/2025 datë 12.06.2025



Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi

Manushe Karaçi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi palë e pakëndqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së